



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT**

**Seksioni për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve**

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

**Nr.**                      **Prot.**  
**Nr. Dok. 201800670/9**

**Tiranë** \_\_\_/\_\_\_/2019

**Lënda :**     *Rekomandime për të garantuar një ushqyerje të shëndetëshme me qëllim garantimin e një zhvillimi normal tek fëmijët e çerdheve dhe kopshteve për pakësimin e sëmundjeve me origjinë ushqimore.*

**MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE**

**QËNDRA EKONOMIKE E ZHVILLIMIT DHE EDUKIMIT TË FËMIJËVE  
DREJTORI I PËRGJITHSHËM  
ZNJ. ZHANETA BEQIRI**

**TIRANË**

Pranë institucionit të Avokatit të Popullit, është paraqitur ankesa nga një grup prindërisht, lidhur me ndryshimet e menuesë së çerdheve dhe kopshteve në Bashkinë Tiranë, regjistruar në sistemin e trajtimit të ankesave në emër të ankuses, Ina Kasimati në 17 prill 2018.

E drejta për ushqim të shëndetshëm, si pjesë e të drejtave njerëzore bazë të njeriut u theksua në Konferencën Ndërkombëtare të Ushqyerjes, në vitin 1992, dhe në Samitin Botëror të Ushqimit në 1996, mbështetur në ligjin nr 8137, datë 31.7.1996, "Për ratifikimin e Konventës Evropiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore".

Në këtë kuptim, ushqimi dhe ushqyerja përfshijnë tre komponentë kryesor, sigurimi i ushqimit, siguria ushqimore dhe ushqyerja, të cilat janë përgjegjësi të institucioneve të ndryshme. Mbështetur në fushën e veprimtarisë së Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ky institucion dhe institucionet nën varësinë administrative të tij, janë përgjegjës për çështjet që lidhen me ushqyerjen, me fokus ushqyerje e shëndetëshme.

Në këtë kontekst, institucioni i Avokatit të Popullit filloi procedurën e shqyrtimit të çështjes, në bazë të personave të interesuar lidhur me këtë çështje duke kërkuar informacion dhe kopje të dokumentacioneve në rrugë zyrtare institucioneve përgjegjëse, konkretisht, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me shkresat zyrtare nr. K 5/I 24-2 prot. datë 25.4.2018 dhe K5/I24-6 prot., datë 17.12.2018, si dhe Qendrës Ekonomike të Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve, Bashkia Tiranë me shkresën zyrtare K5/I24-4 prot. datë 2.7.2018.

Gjithashtu ju bëj me dije, se dosjet voluminoze të dërguar nga të dyja institucionet janë studiuar me hollësi, të cilat kanë kërkuar kohën e vetë duke qënë tepër specifike si fushë.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dërgoi materialet, të cilat janë përmbledhur shkurtimisht në vlerësim të çështjes për të cilën është nisur hetimi administrative nga institucioni ynë, si më poshtë vijnë:

*1. Rekomandime për ushqyerjen e shëndetshme në Shqipëri, Drejtoria e Shëndetit Publik, Tiranë, Dhjetor 2008.*

Ky dokument udhëzon popullatën për një ushqyerje të shëndetëshme dhe ka për qëllim të mbrojë dhe promovojë shëndetin duke patur si objektiv kryesor pakësimin e sëmundjeve me origjinë ushqimore. Në këtë dokument, piramida CINDI dhe materiale të tjera të botuara në OBSH-ja, kanë shërbyer si model në përgatitjen e Udhezuesit, së bashku me materiale të tjera të vlefshme të botuara nga autorë të shquar në këtë fushë. Vlen për tu theksuar mbështetja permanente e dhënë gjatë gjithë procesit nga Zyra e OBSH-së Tiranë.

*2. Raport, iniciativa eurvejancës së obezitetit në moshën feminare në Republikën e Shqipërisë: rezultatet e vitit 2016, Instituti i Shëndetit Publik, Tiranë, shtator 2016.*

Referuar rekomandimeve të publikuara në këtë studim lidhur me trajtimin e çështjes në fjalë, theksojmë rekomandimet, si më poshtë vijon:

- Të rritet pranimi dhe konsumi i frutave dhe perimeve nga ana e fëmijëve;
- Të sigurohet një qasje në të gjitha mjediset, ku gjenden fëmijë, për ujë të pijshëm dhe të inkurajohet konsumi i mjaftueshëm ditor i tij, sipas nevojave të çdo fëmije.
- Të ulët qasja për ushqime dhe pije të ëmbla që në moshë të hershme të fëmijës, kur sapo fillon ushqyerja plotësuese e tij, si

dhe të reduktohet disponueshmëria e ushqimeve me përmbajtje të lartë kalorike në shtëpi apo mjedise të tjera si shkolla/ qendra argëtimi për fëmijë, etj. ku gjenden fëmijë.

3. *Komiteti i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës në vëzhgimet përfundimtare të raportimit të Shqipërisë në vitin 2012, ka rekomanduar trajtimin me prioritet të kequshqimit tek fëmijët, duke u fokusuar, së pari në kategoritë e fëmijëve më në nevojë, edukatën e të ushqyerit dhe mundësitë për ushqim cilësor;*

Nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale janë marrë masa në kuadër të përmirësimit të legjislacionit. Ligji për nxitjen dhe mbrojtjen e të ushqyerit me gji i vitit 1999, u rishikua dhe u përshtat me Kodin Ndërkombëtar të Tregimit të Zëvendësuesve të Qumështit të Gjirit (ligji nr. 53/2016), dhe u pasua me hartimin e dy rregulloreve: vendimit të Këshillit të Ministrave nr.116/2017, që rregullon etiketimin e produkteve zëvendësuese të qumështit të gjirit, dhe urdhri i Ministrit të Shëndetësisë nr. 179/2017, që rregullon përmbajtjen edukuese dhe informuese për ushqyerjen e foshnjave dhe fëmijëve.

4. *Bazat e ushqyerjes ,ushqyerja e gruas shtatzënë, ushqyerja e fëmijës, Tiranë 2011.*

Ky dokument përmbanë modulet e integruara të trajnimeve për gratë shtatzëna dhe ushqyerjen e fëmijëve, mbështetur në risitë moderne të kohëve të fundit për ushqyerjen e këtyre grupeve dhe kurbave të reja të rritjes sipas monitorimeve të OBSH-së, të cilat janë miratuar falë trajnimit të personelit nga Qendra Kombëtare e Arsimit në Vazhdim. Janë organizuar edhe disa trajnime të tjera shtesë nga ISHP-ja për përmirësimin e ushqyerjes së fëmijëve, duke u përqendruar në ushqyerjen e shëndetshme, parandalimin e obezitetit dhe treguesit e ushqyerjes.

5. *Studimi Demografik dhe Shëndetësor në Shqipëri 2008-09, Instituti i Statistikës, Instituti i Shëndetit Publik Tiranë, Shqipëri, ICF Macro, Calverton, Maryland, USA, Mars 2010.*

Ky studim kombëtar është realizuar mbi një kampion përfaqësues kombëtar, i projektuar për të dhënë informacione mbi çështjet e shëndetit dhe të popullsisë në Shqipëri. ADHS u krye nga Instituti Kombëtar i Statistikës (INSTAT) dhe Instituti i Shëndetit Publik (ISHP), nën drejtimin e Ministrisë së Shëndetësisë të Republikës së Shqipërisë.

6. *Obesiteti në fëmijëri, në Evropë, nisura e mbikqyrjes, OBSH, (ËHO European Childhood Obesity, Surveillance Initiative, Implementation of round 1, 2007/2008 and round 2 2009/2010)*
7. *Vlerësimi i obezitetit në moshën feminare, instituti i shëndetit publik, Tiranë, maj 2013.*

Referuar rekomandimeve të publikuara në këtë studim lidhur me trajtimin e cështjes në fjalë, theksojmë rekomandimet, si më poshtë vijon:

- Parandalimi është mënyra me raportin më të mirë kosto-përfitim për kontrollin e mbipeshës dhe obezitetit në moshën pediatrike, e në të ardhmen, në moshën adulte.
- Fëmijët konsiderohen popullata prioritare për strategjitë e parandalimit, sepse humbja në peshë në moshë të rritur është e vështirë dhe ekziston një numër më i madh ndërhyrjesh të rëndësishme për fëmijët se për të rriturit.
- Parandalimi mund të arrihet nëpërmjet ndërhyrjesh të ndryshme që kanë si target: mjedisin, aktivitetin fizik dhe dietën.

Edhe në vendin tonë është e nevojshme një punë në rrjet për parandalimin e obezitetit, duke qenë se obeziteti është një sëmundje multifaktoriale për të cilën ndërhyrjet parandaluese duhet të vendosen në të gjithë faktorët shkaktues. Në bazë të të gjitha këtyre që thamë më lart do të jetë e rëndësishme:

- Forcimi i sistemit të vlerësimit nutricional të moshës feminare që paraqet incidencën dhe prevalencën e mbipeshës dhe obezitetit në këtë grup popullate, si dhe krijimi dhe ofrimi i modeleve të ushqyerjes së shëndetshme dhe të aktivitetit fizik;

Në përputhje me pikën 1, të nenit 46, të ligjit nr.10138, datë 11.5.2009, “Për shëndetin publik”, të ndryshuar, Ministri i Shëndetësisë ka detyrimin për të miratuar udhëzuesit kombëtar të ushqyerjes së shëndetëshme për grupe të ndryshme të popullatës.

Nga vlerësimi në përmbajtje të materialeve të dërguara nga ky institucion korendikon se, materiali me titull “*Rekomandime për ushqyerjen e shëndetshme në Shqipëri, Drejtoria e Shëndetit Publik, Tiranë, Dhjetor 2008*”, ku është e publikuar edhe logoja edhe Ministrisë së Shëndetësisë është dokument udhëzues për popullatën për një ushqyerje të shëndetëshme dhe ka për qëllim të mbrojë dhe promovojë shëndetin duke patur si objektiv kryesor pakësimin e sëmundjeve me origjinë ushqimore.

Ndërkohë, në vlerësimin të detyrimit ligjor të sipërcituar dhe formës që duhet të ketë një udhëzues, ky dokument nuk përmbanë as numër, dhe as datë, të miratimit nga autoriteti përgjegjës, si dhe botimit të këtij dokumenti në fletoren zyrtare, ndaj nuk mund të konsiderohet akt korrekt nënligjor.

Në vazhdimësi, vlen për të përmendur, se shkresa e dytë zyrtare drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, nga institucioni ynë me nr. K5/I24-6 prot., datë 17.12.2018, konsistonte pikërisht në dërgimin e informacionit korrekt nga ana e ministrisë me aktin nënligjor të miratuar, në përmbushje të detyrimit ligjor në përputhje me pikën 1, të nenit 46, të ligjit nr.10138, datë 11.5.2009, “Për shëndetin publik”, të ndryshuar.

Në informacionin e kërkuar dhe kopje të dokumentacioneve përkatëse për zhvillimin e procedurave të ndjekura për miratimin e menusë së re, Ministria e Shëndetësisë na informan si vijon:

Bashkia Tiranë nëpërmjet Qendrës Ekonomike e Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve në shkresat zyrtare nr. 69, datë 12.1.2018 dhe nr.69/1, datë 22.1.2018 drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka kërkuar miratimin e menusë së re bashkëlidhur shkresës së bashku me arsytimin përcjellëse referuar burimeve përkatëse<sup>1</sup> të përgatitur nga shtetaset Blerina Bombaj, dietologe klinike, Vojsava Karafili, mjeke dhe Nertela Mulla Merceloge.

Mbështetur në legjislacionin vendas, ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ka miratur urdhërin nr.76, datë 23.1.2018, “Për ngritjen e grupit të punës për vlerësimin e menuve ushqimore të çerdheve dhe kopshteve për fëmijët 0-6 vjeç”. Në përbërje të grupit të punës janë 6 përfaqësues nga MSHMS, shtetasit Errol Çomo, Enida Xhumari, Eralda Mariani, Vojsave Gjolliku, një përfaqësues nga Institutit të Shëndetit Publik shtetësja Jolanda Hysko, një përfaqësuese nga Spitali Universitar Obsterik-Gjinekologjik “Koco Gliozheni” dhe një përfaqësues nga Bashkia Tiranë.

Grupi i punës në shkresën zyrtare me nr.582/2 prot., datë 24.1.2018 i ka përcjell, Ministrinë të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale relacionin lidhur propozimet e bera nga Bashkia Tiranë. Në përmbajtje të relacionit, grupi i punës, së pari ka

---

<sup>1</sup> Understanding normal and clinical nutrition (tenth edition);  
Krause’s Food & Diet therapy: Life cycle Nutrition-Infancy, Childhood and Adolescence (14 th edition);  
Dietary Recommendations for Children and Adults;  
Dietary Reference Intake (DRI): Recommended Dietary Allowances and Adequate intakes, Vitamins, Elements;  
Food and Nutrient Board, Institute of Medicine, National Academies;  
American Heart Association Dietary Guidelines and Strategies for Children;  
ËHO (children whose diet contained olive oil had a lower likelihood of increasing their body mass index Z-score over 1 year. Gracia –Serrano S, Rubio-Martin E, Garcia-Fuentes E, Lopez-Sigureo JP, Soriguer F, Rojo-Martinez G. Eur J Endocrinol. 2011 Sep, 165(3);435-9. doi: 10.1530/EJE-11-0273.Epub 2011 Jun 29.

shprehur vlerësimet dhe ristë që sjellin menutë e propozuara për cerdhet dhe kopshtet të fëmijëve të grupmoshës nga 0-6 vjeç, së bashku me referencat, ku janë bazuar (rreth nje faqe formati A4).

Gjithashtu, në përmbatje të këtij relacioni, grupi i punës ka evidentuar edhe mospërputhje me rekomandimet kombëtare dhe referencat e miratuara nga ministria përgjegjëse për Shëndetësinë<sup>2</sup>, konkretisht:

- së pari, fillimi i ushqimit shtese në moshën 4-6 muaj, ndërkohë që rekomandimet e OBSH janë për ushqyerjen vetëm me gji deri në 6 muaj, si dhe fillimin e ushqimeve shtesë pas moshës 6 muaj;
- së dyti, menutë e propozuara kanë futur formulën foshnjore pas moshës 6 muajsh, kjo mënyrë ushqimi indikon përdorimin e biberonit duke e përballur foshnjën ne risqet e mënyrave të tilla të ushqyerit, e sidomos në mjedise kolektive siç është çerdhja;
- së treti, futja e vezës (e verdha) që në moshën 6 muaj, ndërkohë që rekomandimet kombëtare e përfshijnë në moshën 8 muaj;
- së katërti, eliminimin e gjalpfit dhe zvendesimin me vajin extravergin të ullirit me qëllim kufizimin e yndyrnave të ngurta të koleterolit, të cilat tenton t'i balancojë me shtimin e marrjes së vezës që prej moshës 6 muaj e në vazhdim;
- së pesti, përfshirjen e mishit të bluar dhe lengun e gockave në menu që në moshën 6 muaj, në vaktin e drekës;
- së gjashti, përjashtimin e bukës së grurit dhe zvendësimi i plotë me bukë thekre;
- së shtati, përfshirja e ushqimeve të paaplikuara më parë në menutë e propozuara duhet të marrin në konsideratë edhe qëndresën apo kundërshtin nga komuniteti i prindërve, ose publiku i gjerë, pasi, përveç vlerave nutricionalë duhen të marren në konsideratë edhe elementë të tjerë të rënësishëm që përcaktojnë zgjedhjet ushqimore të një gruppopullate si tradita, zakonet apo produktet lokale vendase;
- së teti, fokusi është edhe cfarë lloji qumështi do të sigurohet në verdhe dhe kopështe.

Nisur nga gjetjet e sipërcituara, grupi i punës ka propozuar në të njëjtën kohë edhe rekomandimet përkatëse si dhe miratimin e menuve të propozuara.

Gjithashtu, në shkresat bashkëlidhur (konkretisht shkresa nr.6) është dërguar urdhëri nr.76/1 datë 24.1.2018, të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes

---

<sup>2</sup>Protokollet e praktikës klinike dhe udhëzuesit për ushqyerjen e foshnjave të vegjël dhe grave shtatzëna. Ushqyerja e foshnjave dhe fëmijëve deri në 3 vjeç-Rekomandimet standard të Bashkimit Evropian”

Sociale “Për miratimin e ndryshimeve në menutë ushqimore të çerdheve dhe kopshteve për fëmijët 0-6 vjeç”.

Në mbështetje të pikës 10, të urdhërit të sipërcituar, njoftohen të gjitha strukturat përgjegjëse të Shëndetit Publik dhe bashkitë dhe inspektoriatet përkatëse për zbatimin e këtij urdhëri.

Në këtë kuptim, pavarësisht së, kërkesën për ndryshimin e menuve e ka bërë Qendra Ekonomike e Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve Tiranë, urdhëri është detyrim për t’u zbatuar nga të gjitha institucionet përgjegjëse shtetërore që ofrojnë shërbime të zhvillimit dhe edukimit për fëmijët e grupmoshës 0-6 vjeç.

### **Bashkia Tiranë**

Vlerësimi i kopjeve të dokumentacioneve të vëna ne dispozicion nga Bashkia Tiranë:

- kopje të kërkesave të prindërve për ndryshimin e menuve ushqimore që i përkasin periudhës kohore të vitit 2017;
- kopje të raporti të realizuar nga save the children
- kopje të urdhërit nr.76/1 datë 24.1.2018, të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale “Për miratimin e ndryshimeve në menutë ushqimore të çerdheve dhe kopshteve për fëmijët 0-6 vjeç”;
- kopje të shkresës zyrtare nr. 69/3 prot, datë 16.5.2018, të Qendrës Ekonomike e Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve Tiranë, Bashkia Tiranë drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
- kopje të shkresës nr.24684/1 datë 2.7.2018 të Bashkisë Tiranë me anë të së cilës është përcjell urdhëri nr. 457, datë 13.6.2018 i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;

Në informacionin e kërkuar dhe kopje të dokumentacioneve përkatëse për zhvillimin e procedurave të ndjekura për miratimin e menusë së re, Bashkia Tiranë, na informan si vijon:

Bashkia Tiranë nëpërmjet Qendrës Ekonomike e Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve në shkresat zyrtare nr. 69, datë 12.1.2018 dhe nr.69/1, datë 22.1.2018 drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka kërkuar ndryshimet e menusë, duke e shoqëruar kërkesën, me arsyetimin për nevojat e aplikimit të menusë së re, referuar larmishmërisë së artikujve ushqimorë dhe kalorazhit të dukur për çdo grupmoshë, si dhe draft-menute përkatëse.

Gjithashtu, në shkresën zyrtare me nr. 69/3 prot, datë 16.5.2018, të Qendrës Ekonomike e Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve Tiranë, Bashkia Tiranë drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka bërë kërksë për disa

ndryshime në menutë e reja, miratuar në janar të vitit 2018, konkretisht, po rendisim disa sugjerime:

- për grupmoshën 1-3 vjeç;
  - ditën e hënë, sallata me perime të ziera të zvëndësohet me supë me prime dhe mish viçi;
  - ditën e martë, në mëngjes, të hiqet vaji i ullirit nga veza e zier dhe sasi e këtij vaj ulliri t'i shtohet trahansë, thjerrëzave/fasuelev dhe puresë, në drekë, të hiqet fare speci i kuq i pjekur dhe në vaktin e zëmërës, të hiqet taratori dhe të zvëndësohet me kos me frut të sitnës si dhe bukë me gjizë;
  - ditën e mërkurë, në drekë të hiqet veza e supës dhe t'i shtohet kekut të pasdites së ditës së enjte si dhe vaktit të zëmërës t'i shtohet një kokërr vezë për fëmijë, e cila i hiqet ditës së enjte;
  - ditën e enjte, mëngjesi të këmbëhet me vaktin e zëmërës;
  - ditën e premte, të hiqet vaji i ullirit nga veza e zier dhe në vaktin e zëmërës gjiza nga buka me reçel.
  
- Për grupmoshën 3-6 vjeç;
  - Ulja e sasisë së kosit nga 180 ml në 150 ml, heqja e vëzës se nuk konsumohet nga fëmijët, etj.

Për sugjerimet e kërkuara, në shkresën zyrtare të sipërcituar, theksohet se këto ndryshime nuk çenojnë intervalin e vlerave energjitike dhe atyre makroelemente, si dhe bëhen me atraktive për fëmijët duke i bashkëlidhur edhe draft-menune e propozuar me ndryshimet përkatëse.

Në përgjigje të kërkesës së bashkisë Tiranë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në shkresën zyrtare me nr.24684/1, datë 2.7.2018, ka deleguar urdhërin nr.457, datë 13.6.2018, të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale “Për një ndryshim të urdhërit nr.76/1, datë 24.1.2018, për miratimin e ndryshimeve në menutë ushqimore të çerdheve dhe kopshteve për fëmijët 0-6 vjeç”, ka miratuar ndryshimet e menuve të propozuara nga Qendra Ekonomike e Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve Tiranë, Bashkia Tiranë.

Institucioni i Avokatit të Popullit për të siguruar realizimin efektiv të funksioneve publike administrative në shërbim të personave (në rastin konkrete fëmijëve që marrin shërbime e ushqimit në institucionet e arsimit parashkollorë), si dhe mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të tyre, në realizimin e këtyre funksioneve duke zbatuar parimin e procesit të rregullt ligjor, vlerësoi dhe analizoi saktë informacionin, provat, dokumentacionet dhe raportet të vëna në dispozicion nga institucionet e lartpërmendura veçmas, për të vërtetuar veprimet ose mosveprimet



e ndërmarra nga ana e tyre. Gjithashtu, u krye edhe vlerësimi i hollësishëm i të gjitha provave së bashku, për të marrë rezultatin tërësor të hetimit administrativ. Në përfundim, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, dhe institucionet nën varësinë administrative të tij, si institucione përgjegjëse për çështjet që lidhen me ushqyerjen, me fokus ushqyerje të shëndetshme ka ndjekur procedurat, për ngritjen e grupit të punës, për vlerësimin e menuve të propozuara nga Qendra Ekonomike e Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve Tiranë, Bashkia Tiranë dhe brenda një afati kohorë shumë të shkurtër, prej tre ditësh, ka miratuar me urdhër<sup>3</sup>, menutë e propozuara, pa asnjë ndryshim në përmbajtje të menuve të propozuara.

Kjo procedurë është ndjekur edhe me propozimet e bëra, për herë të dytë nga i njëjti institucion, Qendra Ekonomike e Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve Tiranë, Bashkia Tiranë brenda katër muajsh, ku Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale miraton me urdhër<sup>4</sup>, pa asnjë ndryshim në përmbajtje të gjitha propozimet e kërkuara nga ky institucion.

Ndërkohë, në përmbajtje të urdhërit<sup>5</sup> të ndryshuar institucionet për zbatimin e këtij urdhëri janë, strukturat përkatëse të Shëndetit Publik, bashkitë në të gjithë Republikën e Shqipërisë, Qendra Ekonomike e Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve Tiranë, Inspektoriati Shtetëror Shëndetësor dhe Inspektoriati Qendror dhe Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Në këtë kuptim, institucioni i Avokatit të Popullit, mbështetur në legjislacioni në fuqi, shpreh shqetësimin, se veprimet e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për ndryshimin ose rishikimi i menusë ushqimore duhet të kryhen në përputhje me rrethanat dhe kushtet për të përmirësuar shëndetin, duke u fokusuar tek ushqimi dhe ushqyerja e shëndetëshme, për të gjithë fëmijët që marrin shërbime në kopështe dhe çerdhe të vendit tonë, me qëllim realizimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve mbi parimin e ndarjes së përgjegjësisë, ndërmjet prindit ose kujdestarit të tij, autoriteteve shtetërore dhe shoqërisë, ku ka konstatuar se:

**së pari**, urdhëri duhet të gjejë zbatim nga të gjitha institucionet e administratës publike përcaktuara në të, si dhe detyrimin që kanë këto institucione për raportim për zbatim të tij në terren, për të bërë të mundur realizimin e qëllimit të urdhërit, ushqim cilësor për të gjithë fëmijët e vendit tonë, që marrin shërbime në çerdhe dhe kopshte. Provat dhe dokumentacionet, të vëna në dispozicion, tregojnë se, ky

---

<sup>3</sup> Urdhëri nr.76/1 datë 24.1.2018, të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale “Për miratimin e ndryshimeve në menutë ushqimore të çeredheve dhe kopshteve për fëmijët 0-6 vjeç”.

<sup>4</sup> urdhëri nr. 457, datë 13.6.2018 i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;

<sup>5</sup> Urdhëri nr.76/1 datë 24.1.2018, të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale “Për miratimin e ndryshimeve në menutë ushqimore të çeredheve dhe kopshteve për fëmijët 0-6 vjeç”.

proces është fokusuar vetëm në propozimet e Qendrës Ekonomike të Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve Tiranë, pa patur një raportim/vlerësim gjithëpërfshirës të të gjitha institucioneve të përfshira në këtë urdhër.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka tregues<sup>6</sup> të qartë të qarqeve që kanë nivele të larta kequshqyerjeje dhe anemie të fëmijëve, të cilat janë rritur gjatë periudhës 2016-2017, ku domosdoshmërisht lind nevoja e marrjes së opinioneve të tyre.

**së dyti,** institucioni i Avokatit të Popullit vlerësoi dhe analizoi materialet e dërguara me kopje elektornike (CD), konkretisht materialit, *rekomandime për ushqyerjen e shëndetshme në Shqipëri, Drejtoria e Shëndetit Publik, Tiranë, Dhjetor 2008*, udhëzuesit kombëtar të ushqyerjes së shëndetshme të botuar, por jo të miratuar. Pavarësisht, pyetjes së drejtëpërdrejtë drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nga institucioni i Avokatit të Popullit, në shkresën zyrtare nr. K5/I24-6prot, datë 17.12.2018, lidhur me detyrimin në mbështetje të pikës 1, të nenit 46, të ligjit nr.10138 datë 11.5.2009 “Për shëndetin publik”, të ndryshuar, të ministrit përgjegjës për miratimin e udhëzuesëve kombëtar të ushqyerjes së shëndetshme, për grupe të ndryshme të popullatës nuk morëm përgjigje zyrtare për numrin, datën dhe botimin e tyre në fletore zyrtare të këtij aktit administrative, udhëzuesëve.

**së treti,** mbështetur në pikën, 5 të nenit 5, të ligjit nr.18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, realizimi dhe mbrojtja e të drejtave të fëmijëve zbatohet mbi parimin e ndarjes së përgjegjësisë, ndërmjet prindit ose kujdestarit të tij, autoriteteve shtetërore dhe shoqërisë për mbrojtjen e fëmijës. Në këtë kontekst, institucionet e administratës shtetërore, strukturat përkatëse të Shëndetit Publik, duhet të organizonin fushata sensibilizues lidhur me propozimet e reja për ndryshimet e menuve me prindërit e fëmijëve të çerdheve dhe kopshteve duke marrë në konsideratë qëndresën dhe kundërshtit e tyre si rezlutat e aplikimit të ushqimeve të reja, të cialt nuk janë në përputhje me zakonet dhe mënyrën e të ushqyerit të komunitetit tonë.

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 63 të Kushtetutës Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga organet e administratës shtetërore.

Në përfundim, ajo që do të sugjeronim në kuadër të marrjes së masve për mbrojtjen dhe promovimin e shëndetit tek fëmijët, për të bërë të mundur marrjen e sasisë dhe cilësisë së përshtatshme me velra ushqyese nëpërmjet ushqimeve në

---

<sup>6</sup> Raporti i Pestë Periodik i Shtetit të Republikës së Shqipërisë për Komitetin për të Drejtat e Fëmijës

funksion të garantimit të interesit më të lartë të fëmijëve, institucioni i Avokatit të Popullit referuar parashtrimin të mësipërm, për çështjen në fjalë:

### **REKOMANDOJMË:**

- Të merren masa për të kryer një vlerësim të zbatimit të urdhërit të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 76/1, datë 24.1.2018, “Për miratimin e ndryshimeve në menutë ushqimore të çerdheve dhe të kopshteve për fëmijët 0-6 vjeç”, të ndryshuar në rang kombëtar duke kryer analiza krahasuese me treguesit konkretë të qarqeve që kanë nivele të larta kequshqyerjeje dhe anemie të fëmijëve.
- Të merren masa për të miratuar në zbatim të legjislacionit në fuqi, udhëzuesit kombëtar të ushqyerjes së shëndetëshme në përputhje me detyrimin ligjor mbështetur në pikën 1, të nenit 46, të ligjit nr.10138 datë 11.5.2009 “Për shëndetin publik”, të ndryshuar.
- Të merren masa nga strukturat përkatëse të shëndetit publik, në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe strukturave të bashkisë për organizimin e fushatave sensibilizies me metoda efektive mbi nevojën e ushqyerjes së shëndetëshme për gjatë gjithë ciklit të jetës të fëmijëve me qëllim uljen e riskut për kultivimin e zakoneve jo të mira ushqyese tek fëmijët që në moshë të hershme.

Duke Ju falënderuar për mirëkuptimin dhe, në vijim të bashkëpunimit, ndërmjet institucioneve tona, në funksion të përmbushjes së detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, për garantimin me efektivitet të ushtrimit, respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijës, lutemi shqyrtimin e këtij rekomandimi e, në vijim të na informoni për qëndrimin Tuaj ndaj tij.

**K O M I S I O N E R**

**Nejla PEKA**